



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 90, datë 26.07.2021

PËR

**VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË OBJEKTIT
PALLATI XHAFZOTAJ ME KOD GIS 74731, RRUGA “GJON KASTRIOTI”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRASHBULL, DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vlerësimit të aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese Pallati Xhafzotaj, Kod GIS 74731, në rrugën “Gjon Kastrioti”, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, të hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë përcjellë pranë institucionit tonë me shkresën protokolluar me tonën nr.1659/4, datë 28.06.2021, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Vijimin e procedurës së prishjes së detyruar të objektit pallati Xhafzotaj, me kod GIS 74731, Rruga “Gjon Kastrioti” Bashkia Durrës, ndodhur në Njësinë Administrative Rrashbull, në zbatim të Vlerësimit të aftësisë mbajtëse strukturore të hartuar nga Instituti i Ndërtimit

Tiranë, dhe rindërtimin në truallin ekzistues duke respektuar kondicionet urbane parashikuar ne aktet ligjore në fuqi, që operojnë në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë, që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të Vendimit Nr.887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative Rrashbull.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë, që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, Drejtoria e Kabinetit dhe Njësia Administrative Rrashbull.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.07.2021



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 549 / prot. 3



Durrës, më 30.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.90 datë 26.07.2021

“Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të objektit pallati Xhafzotaj me kod gis 74731, rruga “Gjon Kastrioti”, Njësia Administrative Rrashbull, Durrës

Ë gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

